

P.nr.323/13

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ Departamenti i përgjithshëm – Divizioni penal, në përbërje nga gjyqtari individual Hysnije Gashi, me procesmbajtësen Hajrije Arifi, sek. juridike në këtë gjykatë, në çështjen penale kundër të akuzuarës, A.G. , për shkak të veprës penale mashtrimi nga nen. 261 par.2. të KPPK-së, dhe të akuzuarit Sh.G., për shkak të veprës penale dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprës penale nga neni 305 par 1 të KPK-së sipas aktakuzës së Prokurorisë Komonale në Ferizaj Pp.nr. 1338-3/12 dt. 26 shtator 2012, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik me dt.07.07.2014, 14.07.2014 dhe dt. 25.06.2007 në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurorit Shukri Jashari , të akuzuarve dhe mbrojtësve Av. N.P. dhe Av. Xh.M. , përfaqësuesit të dëmtuarit Av.M.H., me datë 22.07.2014 mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

1. E akuzuara A.G nga, rr ”.....” nr.. data e lindjes.....në të njëjtin vend , nga i ati H. dhe e ëma M. e gjinisë L., Shqiptare ,shtetase e Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme , ekonomiste, e martuar, e gjendjes së mesme ekonomike, mbrohet në liri.

2. I akuzuari SH.G. nga fshati komuna Pejë, data e lindjes....., në të njëjtin vend nga i ati B., e ëma H. e gjinisë B., i martuar , baba i dy fëmijëve ,shtetas i Republikës së Kosovës ,i gjendjes së mesme ekonomike .

JANË FAJTOR

A.G.

Sepse nga muaji gusht deri në dhjetor të vitit 2011, në Ferizaj me qëllim që vetes t'i sjell dobi pasurore , e ka mashtruar të dëmtuarin Rr.K., në atë mënyrë që e pandehura është paraqitur në cilësinë e drejtoreshës së OJQ –së SH.I.P.P.L nga Peja dhe duke përdorur kontratën e falsifikuar ne nr.....të datës 15.08.2011 ka arritur që ta bind të dëmtuarin Rr.K. të i jap material ndërtimor nga depoja e tij “.....” me seli në Ferizaj, kinse në emër të projektit humanitar “Duam dhe mundemi së bashku “ duke marr material ndërtimor në vlerë prej 153.000,00 euro (njëqindpesëdhjetetremijë)euro të cilin material e ka dërguar në depon ndërtimore në Pejë tek pronari Sh.G..

- me të cilën ka kryer veprën penale mashtrimi nga nen. 261 par. 2. të KPK-së.

Sh.G.

Prokurori i shtetit Shukri Jashari në fazën e ndryshimit të akuzës ndaj të akuzuarit Sh.G. bëri kualifikimin e veprës penale.

Sepse me datën 08.tetor 2011 deri në dhjetor të vitit në fshatin Qyshk të Pejës ka ndihmuar të akuzuarën A.G. në shmangien e zbulimit të veprës penale të mashtrimit ,në atë mënyrë që paraprakisht i ka pranuar që të akuzuarës së parë t'ia gjej një depo – pllac me qëllim që të shkarkohet materiali ndërtimor të cilën e ka dërguar me porosinë e të akuzuarës së parë i dëmtuari Rr.K..

Me të cilën kreu veprën penale,dhënja e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprës penale nga neni 305 par 1 të KPK-së

Po ashtu ka bërë përmirësimin e dipozitivit të akuzës ashtu që në rreshtin e 8 ku është vlera 153.000,00 euro duhet të jetë 153.908.48 €,

Andaj gjykata në bazë të nen. 3, 34, 36, 3, 73, të KPK-së dhe nenit 365 të KPPK-së të akuzuarit i :

GJYKON

1. Te akuzuarën A.G.

DËNIM BURGIMI në kohëzgjatje prej 3 /tri/ viteve, në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga dt. 24.06.2014 deri me datën 22.07.2014.

Në bazë të nenit 367.1 nën .par 1.2. të KPK-së Gjkata me aktvendim të veçante ndaj të akuzuarës e ka ndërpre masën e paraburgimit.

1. Në bazë të nen. 458 të KPPK-së obligohet e akuzuara që në emër të kërkesës pasurore-juridike të dëmtuarit Rr.K. t' ia kompensoje shumën prej 152.908.45 €, për kamatën ligjore i dëmtuari udhëzohet në kontest civil.

Të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

2. Të akuzuarin Sh.G.

I CAKTON DËNIM BURGIMI në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj i cili konform nenit 38 par 3 të KPK-së, i zëvendësohet në dënim me gjobë në lartësi prej 1.350,00€(njëmijetrqindpesëdhjet)euro të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

Nëse dënimi ne gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra tjera të parapara në nenin 39 par.3 të KPK-së Gjykata do ta ekzekutoj aktgjykimin në at mënyrë që të pandehurit Sh.G. për çdo 15 € të gjobës do ta vuaj një ditë burg.

Obligohen te akuzuarit qe secili veç e veç të paguajnë shpenzimet për paushallin gjyqësor ne shume prej 50 € ,dhe shpenzime e procedurës penale ne shumen prej 25 € ne afat prej 30 ditësh pasi qe aktgjykimi te merr formën e prere .

A r s y e t i m i

Ish Prokuroria Publike Komunale në Ferizaj me aktakuzën PP.nr. 1338-03/2012 ka ngarkuar të akuzuarën A.G. për veprën penale mashtrimi nga neni 261 par.2 të KPK-së dhe të akuzuarin Sh.G. për veprën penale dhënja e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprës penale nga neni 305 i KPK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj aktakuze, mbajti shqyrtimin gjyqësor, me datë 14.07.2014,22.07.2014, në të cilën përfaqësuesi i akuzës, prokurori i shtetit Shukri Jashari , në fazën e ndryshimit të akuzës beri ndryshimin e akuzës sikurse në diapozitivin e këtij aktgjykimi ndaj të akuzuarit Sh.G., duke mbetur në tersi pranë akuzës së zgjeruar dhe ri cilësuar, i propozoi gjykatës që të akuzuarit të shpallen fajtorë dhe ti shqiptohet sanksion penal adekuat me shkallën e përgjegjësisë penale, peshën dhe rrezikshmërinë e kësaj vepre penale .

E akuzuara, A.G. si në procedurën hetimore dhe në shqyrtimin gjyqësor, në mbrojtjen e saj ka deklaruar se nga i dëmtuari Rr.K. pronar i depos ,..... “ ka pranuar material ndërtimor ne emër te projektit nga Ministria per kthim dhe komunitete, për renovimin dhe ndërtimin e shtëpive te minoritareve ne rrethin e Pejës ,duke shtuar se kah viti 2011 ka biseduar me sekretaren permanente ne Ministrin për kthim dhe komunitete Z.K. , e cila e kishte njoftuar për një projekt për ndërtimin e disa shtëpive te

minoriteteve ne Regjionin e Pejës , dhe e njëjta i ka preferuar qe Marrëveshjes së vitit 2008 të cilën e kishte realizuar me këtë Ministri tia largoj faqen e pare dhe te katërt dhe te ia ndryshoj shumen e donacionit e cila është ne vlere prej 540.000 , e me pastaj pasi ta tejkaloj problemin me Euleksin këtë marrëveshje do ta protokollojnë në këtë ministri, pastaj e akuzuara ka deklaruar së këtë marrëveshje e ka falsifikuar, duke ia ndërruar faqen e pare dhe te katërt. E për këtë veprim një personi me emrin B.Th. i ka paguar 300 euro .

Me tej e akuzua deklaron se është takuar ne Ferizaj me I.I. dhe e ka njohtuar se kishte fituar një tender për ndërtimin e disa shtëpive edhe dëshmitari e ka njoftuar me te dëmtuarin , Rr.K. ne nje kafiteri ku e kanë nënshkruar kontratën,dhe ka filluar që të furnizohet me material nga depoja” e qe vlere e mallit qe e ka marre ne depon “..... “ka qene 153 .000€ .

Ketë material e ka dërguar te Sh.G. ne fshatin Qyshk te Pejes, ku e kanë siguruar siguruar një Depo nga një familjar i tij me emrin Sh.K. .dhe nga ai material një pjese e ka dërguar ne fshatin Sig dhe Brestovi, dhe pjesë tjetër të materialit janë marre vesh me Sh.G. ta shesin dhe te hollat tua dërgojnë përfituesve te cilët kishin për ti ndërtuar shtëpitë. Dhe nga materiali i shitur Sh.G. ia ka dorëzuar afro 10.000€

Me tej e akuzuara deklaron se te dëmtuarit Rr.K. ia kam ber nje pagese dhe atë dy here nga 500,€,

I ka propozuar gjykatës qe ta lirojë nga akuza

.

Mbrojtësi i të akuzuarës Av.N.P. ka theksuar se e akuzuara ka marrë material ndërtimor nga i dëmtuari Rr.K., por nuk ka qenë dashja për mashtrim apo për përfitim të kundërligjshëm ,për faktin se tani e akuzuara ka realizuar disa projekte nga Ministrija për kthim dhe komunitete që këtë ja ka bërë të mundur Sekretarja e kësaj Ministrije Z.K. , por e njëjta edhe për interesat e saj i ka ndihmua në përfitimin e projekteve, ku e

sugjeron se është shpallur tender dhe se ajo duhet ti bëjë disa ndërrime në marrëveshjen e mëhershme, e më vonë, do t'ia legalizoj në këtë ministri, e akuzuara ka kryer disa veprime por jo me qëllim të mashtrimit, sepse me mundësit e veta ka filluar ta kompensoj të dëmtuarin, i propozon gjykatës që ta liroj nga akuza të akuzuarën.

I akuzuari Sh.G. nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e akuzohet me aktakuzën e prokurorit dhe atë të ndryshuar në përfundim të shqyrtimit gjyqësor.

Në mbrojtjen e tij në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar; se A.G. e ka njohur si qytetare dhe se e ka ditur që se njëjta ka realizuar disa projekte humanitare, dhe se e ka njoftuar se ka fituar një tender për furnizim me material ndërtimor për ndërtimin e shtëpive të pastrehëve në regjionin e Pejës dhe ajo i ka propozuar që t'ia gjej një vend për ta shkarkuar at material, së bashku janë marrë vesh që materialin ta vendosin në depo tek Sh.K..

Ka deklaruar se është takuar disa herë me A.G., pasi ajo ia ka pasur borgj 2000€ mirëpo nuk e ka njohur personalitetin e saj dhe nuk e ka ditur se ku e ka marr materialin. Por e pohon faktin se një pjesë të materialit ndërtimor e ka shitur dhe nga ajo shitje i ka marrë 2000€, pasi që A.G. ia kishte borgj, kurse pjesën tjetër të hollave ia ka dhënë A.G.

I ka propozuar gjykatës që ta liroj nga akuza.

Mbrojtësi i të akuzuarit Sh.G., Av. Xh.M. ka theksuar se me asnjë provë nuk është vërtetuar se i mbrojturi im ka kryer veprën penale dhënia e ndihmës kryesit të veprave penale e kjo në veçanti rrjedh nga deponimet e të akuzuarës e cila në pyetje të prokurorit ka thënë se “nuk e ka ditë Sh.G. se materiali ndërtimor i strehuar te Sh.K. rrjedh nga vepra penale e mashtrimit sepse edhe unë kam qenë e mashtruar”

Provat e paraqitura ne shqyrtimin gjyqësor

Me qe te akuzuarit nuk e kane pranuar fajësinë për veprat penale sipas pretendimeve te akuzës se prokurorit , gjykata ne shqyrtimin gjyqësor ka bërë, paraqitje e provave të akuzës te cilat u vlerësuan një nga një dhe ne ndërlidhje reciproke me njëra tjetrën , ne kuptim te dispozitave te KPPK-se dhe ne baze ti vlerësimit te tille , gjykata vërtetoi gjendjen faktike te përshkruar si ne diapozitiv te këtij aktgjykimi.

Gjykata ketë gjendje faktike e vërtetoi me provat e paraqitura ne shqyrtimin gjyqësor dhe atë ;

Pjesërisht nga mbrojtja e te akuzuarve , nga dëshmia e dëshmitareve

-Marrëveshja mbi realizimin e projektit ‘Duam dhe mundemi’

-Rekomandimi i përpiluar ne muajin tetor 2011

-Faturat e datës 08.10.2011deri te fatura e fundit 15,12,2011

-kontrata e datës 06 . tetor 2011

-Marrëveshja për realizimin e projektit ‘Duam dhe mundemi se bashku “e datës

15.12.2008.

-lista e SMS te nxjerra nga CD për numrin dërguar ne nr,.....,si dhe lista e SMS-ve nga numri tel,.....dhe

- si dhe shkresa e datës 21.04.2012 e nënshkruar ne mes te pandehurës A.G. dhe te përfaqësuesit te dëmtuarës Av,M.H..

Nga deponimi i dëshmitarit –të dëmtuarit Rr.K. si në procedurën hetimore dhe në shqyrtimin gjyqësor ,vërtetohet se për të akuzuarën ka dëgjuar pëmes një personi me emrin I.I.,dhe se i njëjti e ka njoftuar me tani të akuzuarën e njëjta ia ka prezantuar një Marrëveshjen dhe një rekomandim nga Ministria për kthim dhe komunitete dhe i dëmtuari duke i besuar asaj marrëveshje kishte lidhur kontratën me tani te akuzuarën për furnizim me material ndërtimore në vlerë prej 153.940,00 €.`

Nga deponimi i dëshmitarit I.I. si në procedurën hetimore edhe në shqyrtimin gjyqësor vërtetohet se me të akuzuarën janë takuar në një panair të prodhimeve vendore dhe e njëjta e kishte njoftuar se e kishte fituar një tender për një organizatë jo qeveritare dhe i duhet një furnizues me material ndërtimor, .me tej dëshmitari e kishte ftuar tani të dëmtuarin dhe në prezencën e tij e kishin nënshkruar kontratën me te akuzuarën.Përkitazi me pretendimet e të akuzuarës se dëshmitarit ia kishte dërguar në 300 euro në emër të realizimit kësaj kontrate dëshmitari e mohoi dhe ballafaqim me te akuzuarën duke shtuar se së të hollat ia kishte borgj e akuzuara.

Nga deponimi i dëshmitares Z.K. vërtetohet se të akuzuarën e ka takuar në vitin 2008 e cila e kishte realizuar një një projekt me këtë ministri, me tej ka deklaruar së në fillim të vitit 2012 i dëmtuari Rr.K. kishte shkuar në zyrën e saj dhe kishte ia kishte prezantuar Marrëveshjen dhe Rekomandimin. Dhe se kishte vërejtur se Marrëveshja ka qenë e falsifikuar në faqen e parë për faktin se nuk ka qenë e nënshkruar nga dëshmitarja si dhe faqja e katërt nuk ka qenë e nënshkruar dhe neni 7 i marrëveshjes, ku shuma ka ndryshuar si dhe kjo marrëveshje nuk ishte e protokolluar në këtë ministri. Pretendimeve të akuzuarës se dëshmitarja e kishte sugjeruar që ajo ta ndryshoi marrëveshjen e vitit 2008 në ne ballafaqimin me të abuzuarën dëshmitarja i ka mohuar në tërësi duke theksuar

se njëjta për këtë marrëveshje është njoftuar nga i dëmtuari si dhe atë nuk e ka nënshkruar e as nuk e ka protokolluar në këtë ministri.

Nga deponimi i dëshmitares H.B., nuk u vërtetua se e njëjta i ka ndihmuar të akuzuarës në realizimin e projektit Duam dhe mundemi së bashku dhe se për çdo projekt të realizuar 50 pëqin duhet me ia dhënë Z.K..

Teza e mbrojtësit të akuzuarës, Av.N.P. se në veprimet e të akuzuarës nuk ka qenë dashja për mashtrim apo për përfitim të kundërligjshëm është e pa bazuar për faktin se e akuzuara me paraqitjen e fakteve të rrejshme e ka mbajtur në lajthim të dëmtuarin Rr.K. duke ia prezantuar Marrëveshjen e falsifikuar dhe tek i dëmtuari ka krijuar bindjen se e akuzuara ka paraqit fakte të vërteta e kjo ka qenë arsyeja që të veproj në dëme të pasurisë së tij. Është jo reale se e akuzuara të ketë qenë edhe vet e mashtruar për arsye se në mënyrë perfide e ka mashtruar të dëmtuarin duke i thënë se pagesën do ta beje në fund të muajit fiskal si, dhe për ta mbajt në lajthim të dëmtuarin ka angazhuar shoqen e saja A. që të lajmrohet në telefon ne emër te sekretares permanente në Ministrinë për Kthim dhe komunitete Z.K., duke e mashtruar të dëmtuarin se do ta bëje pagesën e borgjit, fakt të cilin e pranonë edhe vet e akuzuara.

Teza e mbrojtësit të akuzuarit Sh.G. Av.Xh.M. në fjalën përfundimtare i cili në veçanti i referohet deponimit të akuzuarës e cila ka deklaruar se “Sh.G. nuk e ka ditë se materiali ndërtimor i strehuar te Sh.K. rrjedh nga vepra penale e mashtrimit, sepse edhe unë kam qenë e mashtruar“, është e pa bazuar për faktin se e njëjta me marrëveshje me të akuzuarin e kanë marre me qira një depo ku e kanë vendosë materialin ndërtimor dhe të njëjtin e kanë shitur dhe e të hollat i kanë ndarë së bashku.

Andaj, në veprimet e të pandehurës A.G. formësohen të gjitha elementet e veprës penale mashtrim nja neni 261.par 2 të KPK-së për faktin se akuzuara me paraqitjen e fakteve të rrejshme, më qëllim të përfitimit pasuror të kundërligjshëm ka

krijuar bindjen dhe besimin tek i dëmtuari Rr.K. duke ia prezantuar Marrëveshjen mbi Realizimin e projektit “Duam dhe mundemi së bashku” të datës 15.08.2011, të cilën e ka falsifikuar duke ia ndryshuar numrin e protokollit, datën, çmimin e marrëveshjes dhe datën e nënshkrimit. fakt të cilin e ka pranuar e akuzuara, për të arritur qëllimin e saj të mashtrimit dhe e ka bindur të dëmtuarin që të veprojë kundër pasurisë së tij duke lidhur kontratë me shkrim me të akuzuarën i cili ia dorëzuar materialin ndërtimorë në vlerë siç përshkruhet në dispozitiv.

Në veprimet e të pandehurit Sh.G. formësohen të gjitha elementet e veprës penale dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprës penale nga neni 305 par 1.tëKPK-së. I cili në bashkëpunim me të akuzuarën Materialin e pranuar e kanë dërguar në një depo në fshatin Qyshk të Pejës ,dhe materialin e ka shitur e ka shitur për përfitime personale këtë e dëshmojnë edhe SMS-t e tij dërguar të akuzuarës.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në kuptim të nenit 64 të KPK-së ,si rrethana lehtësuese gjykata morri faktin se e akuzuara, të dëmtuarit ia ka bërë një pagesë në shumë 1.000 € , është e moshës relativisht të re, rrethanat familjare, nuk ka të dhëna që më parë ka qenë e dënuar me vendim të formës së prerë, ndërsa si rrethana rënduese gjykata morri rrezikshmërinë shoqërore të kësaj vepre që në rastin konkret ekziston peshë e rëndë dhe rrezikshmëri e lart shoqërore pasi që bëhet fjalë për një shumë në lartësi prej 153.908.48 €.si dhe edhe ekziston shkallë e lartë e përgjegjësisë penale tek akuzuara që në këtë mënyrë të sigurojë përfitim të lartë pasuror të kundërligjshëm, mbi bazën e vlerësimit të gjitha këtyre rrethanave gjykata të akuzuarës i shqiptoi dënim si në dispozitiv, duke qenë e bindur se një dënim të tillë është plotësisht i justifikueshëm në raport me rrezikshmërinë shoqërore të kësaj vepre penale , rrethanave të kryerjes, personalitetit të akuzuarës dhe me të do të arrihet qëllimi ndëshkimorë nga neni 34 i KPPK-së në kuptim të preventivës individuale që tek akuzuara do të ndikojë në mënyrë edukative në parandalimin që në të ardhmen të mos kryejë vepra penale si dhe në kuptim të preventivës gjenerale, parandalimin e përgjithshëm të kësaj vepre penale në shoqëri .

Konformë nenit 112 par.2 të KPPK-së gjykata e obligojë të akuzuarën që ta kompensojë të dëmtarit shumat si në dispozitiv, pasi që është vërtetuar shuma e saktë e borgjit nga e akuzuara.

Në dënimin e shqiptuar është llogaritur koha e qëndrimit në paraburgim të akuzuarës A.G. prej datës 24.06.2014 deri 22.07.2014 , duke aplikuar nenin 83 par 1 të KPK-së ,kurse në kuptim të nenit 367 par.1 nën par 1.2.të KPK-së me aktvendim të veçante ka ndërprere masën e paraburgimit deri sa aktgjykimi të merr formën e prerë.

Në rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënim gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 64 të KPK-së dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se i akuzuari Sh.G. është i moshës relativisht të re ,rrethanat familjare ,ndërsa si rrethanë rënduese morri rrezikshmërinë shoqërore të kësaj vepre ,mbi bazën e vlerësimit të gjitha këtyre rrethanave gjykata të akuzuarit Sh.G. i shqiptoi dënim si në dispozitiv, duke qenë e bindur se një dënim i tillë është plotësisht i justifikueshëm në raport me rrezikshmërinë shoqërore të kësaj vepre penale ,rrethanave të kryerjes ,personalitetit të akuzuarit ,dhe me te do të arrihet qëllimi ndëshkimor nga neni 34 i KPK-së

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor është marrë kon forme nenit 450 dhe 451 të KPPK-së

Obligohen te akuzuarit qe secili veç e veç të paguajnë shpenzimet për paushallin gjyqësor ne shume prej 50 € ,dhe shpenzime e procedurës penale ne shumen prej 25 € ne afat prej 30 ditësh pasi qe aktgjykimi te merr formën e prerë .

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr.323/13 me datë 22.07.2014

Sek juridike,
Hajrije Arifi

Gjyqtari individual,
Hysnije Gashi

Këshilla juridike: kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, nga data e pranimet të këtij aktgjykimi në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.